



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0767

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Kimete Gashi dhe Batisha Ibrahim - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së OE “RIO PLUS” SH.P.K., kundër vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Pastrimin e objekteve edukativo arsimore të Komunës së Prishtinës – LOTO 1 dhe LOTO 2” me numër të prokurimit 616-24-1099-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Komuna e Prishtinës”, më 25/10/2024, mori këtë:

Vendim

1. **Aprovohet si pjesërisht e bazuar** ankesa e OE “Rio Plus” Sh.P.K. kundër vendimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Pastrimin e objekteve edukativo arsimore të Komunës së Prishtinës” me numër të prokurimit 616-24-1099-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës.

2. **Mbetet në fuqi** Njoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues i datës 09.08.2024.

3. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datë 15.02.2024 Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Pastrimin e objekteve edukativo arsimore të Komunës së Prishtinës” me numër të prokurimit 616-24-1099-2-1-1. Autoriteti Kontraktues gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës për shërbim, me vlerë të parashikuar 1,496,200.00€.

Me datë 09.08.2024, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 ku ka shpërblyer me kontratë për lot 1 OE “Laguna” Sh.P.K. ndërsa për lot 2 OE “Aroma Plus Sh.P.K.

Me datë 14.08.2024, operatori ekonomik ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin B58, të cilën AK e ka refuzuar si të pabazuar me datë 16.08.2024.

Me datë 26.08.2024 operatori ekonomik ankues ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2024/0767.

- Mbi fazën e shqyrtimit paraprak -

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet ankimore: OE ankues ka kundërshtuar të gjitha arsyet e evidentuara në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar sipas të cilës OE ankues është shpallur i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit. Pretendimet e OE ankues janë cituar si në vijim:

“Sa i përket pikës 1 - Sa i përket kësaj pike ne kemi bashkangjitur të gjitha sqarimet e kërkuar dhe nuk qëndron kjo pikë pasi që me dt 31.07.2024 kemi plotësuar sqarimet dhe se vlerën e kërkuar e tejkalojm.

Sa i përket pikës 2 - Ne kemi dorëzuar deklaratën e kërkuar dhe sipas nenit 72 kemi qenë të obliguar të kërkonim edhe sqarimin për etiketat e tilla.

Sa i përket pikës 3 - Kjo pikë nuk qëndron pasi që ne kemi dorëzuar DEKLARATË të përgjithëshme ku kemi përfshirë të gjitha deklaratat.

Sa i përket pikës 4 - Sipas kësaj rregullore ne e kemi vazhduar dhe mund ta kishi kërkuar.

Sa i përket pikës 5 - Ne kemi dorëzuar deklarimet konfirmuese të kërkesës së DT-së, dhe nuk qëndron fakti se nuk kemi deklaruar.

Sa i përket pikës 6 - Ne kemi dorëzuar deklarimet konfirmuese të kërkesës së DT-së, dhe nuk qëndron fakti se nuk kemi deklaruar.

Sa i përket pikës 7 - Kërkesë decizive e juaja ka qenë: Ta paraqes analizën financiare me pagën bruto 400 euro per puntor sipas ATK dhe pushimet vjetore sipas Ligjit të Punës dhe materialin higjienik dhe ne kemi bërë analizën konform kësaj.

Sa i pëket pikës 8 - Nuk qëndron pasi që ju keni cekur me të gjitha shpenzimet vlera e pages 400 euro.

Sa i pëket pikës 9 - Nuk qëndron dhe se dallimi është shumë më pak se 2%.

Sa i pëket pikës 10 - Nuk qëndron pasi që e kemi të plotësuar dhe egziston në sistem.

Sa i pëket pikës 11 - Nuk qëndron pasi që kemi dërzuar të gjitha faturat.

Sa i pëket pikës 12 - Ne kemi dorëzuar të gjitha faturat dhe nuk kemi lënë asnjë paisje pa dëshmuar.

Sa i pëket pikës 13 - Ne kemi dorzuar më shumë se 140 copë.

Sa i pëket pikës 14 - Ju e keni kërkuar të noterizuar dhe sa i përketë asaj përmbajtja e dokumentacionit është ne gjuhen shqipe dhe u drejtohet AP në fjalë”.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave -

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 03.09.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës ndërsa me datë 12.09.2024 është dorëzuar raporti i ekspertizës nga eksperti shqyrtues me rekomandimet si në vijim: *“Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që aktiviteti i prokurimit te anulohet në tërësi”.*

Konstatimet e ekspertit shqyrtues: *“Në kërkesën e AK në Njoftimin për Kontratë, është vendosur se operatorët ekonomik mund të dorëzojnë tenderë në vetëm një pjesë. Gjatë analizimit të të njëjtës kërkesë, por në dosje të tenderit, AK- Komuna e Prishtinës ka vendosur tjetër kriter - opsioni se, operaorët ekonomik duhet të paraqesin tenderë në të gjitha pjesët. Eksperti shqyrtues gjatë trajtimit të dëshmimeve lidhur me pretendimin për kërkesën sqaron se nuk mund të trajtohet një pretendimin me një kërkesë e cila nuk është në pajtim me rregulloren për prokurim publik nr. 001-2022, neni 18, 18.1 dhe 18.2. Pasi që kjo kërkesë nuk është në përputhje (e njëjtë) në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, dhe e njëjta në këtë fazë nuk mund të rregullohet (ri-parohet) eksperti shqyrtues vlerëson se procedura duhet të anulohet në tërësi”.*

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësar e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë nuk janë të qëndrueshme. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues nuk i ka falur besimin ekspertit shqyrtues sa i përket pretendimeve të operatorit ekonomik ankues.

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka vepruar në përputhje me LPP në fuqi.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Paneli Shqyrtues ka gjetur se OE ankues është eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit si ofertues i papërgjegjshëm me arsyetimin e prezantuar në letrën standarde për tenderues të eliminuar si vijon:

“1. Lista e kontratave nuk e përmbush kërkesën për vlerën minimale të përcaktuar. Për kontratën me nr. 9 në listën e kontratave të OE Rio Plus SHPK me blerësin privat Primat ShPK, OE Rio Plus Sh.P.K. nuk e ka dërguar kontratën, kopjet e transaksioneve bankare apo raportet e pranimit të shërbimeve dhe dokumentet tjera të nënshkruara nga blerësit privat sipas kërkesës së AK për sqarime të datës 29.07.2024. Ndërsa kontrata nr. 11 në listën e kontratave të OE Rio Plus SHPK me blerësin privat Mantro ShPK nuk është marrë parasysh nga AK pasi që kjo kontratë ka përfunduar pas publikimit të njoftimit për kontratë nga AK dhe si e tillë është në kundërshtim me kërkesën përkatëse të DT. Ndërsa për kontratën me nr. 4 në listën e kontratave të OE “Skyfterat-Live” Sh.P.K. me AK “Komuna e Gjakovës” me titull “Shërbimet e Pastrimi dhe mirmbajtja hixhenike e objekteve KPSH- Gjakovë”, as pas sqarimeve shtesë që janë kërkuar nga AK me dt. 29.07.2024 nuk është dorëzuar referenca nga AK Komuna e Gjakovës (në vend të saj është lëshuar një referencë nga QKMF Gjakovë në të cilën nuk evidentohet fare titulli i kontratës për të cilën është lëshuar). Vlera e përgjithshme e të gjitha kontratave tjera të GOE nuk mjaftojnë për të mbuluar vlerën e përcaktuar me DT për lotet që ka ofertuar GOE.

2. Mungojnë MSDS dhe etiket kopje të produktit që është dashur të bashkangjiten me deklaratën e GOE se materialet e përdorura janë ekologjike dhe të atestuara.

3. Mungon deklarata se punëtorët do të paguhën jo më vonë se deri me datën 5 të muajit vijues.

4. Raporti mbi vlerësimin e riskut në vendin e punës ka skaduar që nga data 29.09.2023 (raporti ka vlefshmëri kohore jo më shumë se 2 vite sipas nenit 15 par. 1 të Rregullores MPMS nr. 02/2021 për vlerësimin e riskut në vendin e punës.
5. GOE ka dorëzuar një deklaratë se do të punësoj 51 punonjës për lot 1 dhe për lot 2 (22 nga AK dhe 29 nga OE). Në DT për lot 1 janë kërkuar 140 punëtor dhe jo 51 (77 nga AK dhe 63 nga OE).
6. GOE ka dorëzuar një deklaratë se do të punësoj 140 punonjës për lot 1 dhe për lot 2. Në DT për lot 2 janë kërkuar edhe 51 punonjës të tjerë dhe 140 punonjës mjaftojnë vetëm për lot 1.
7. Në analizën financiare nuk është kalkuluar edhe menaxheri i kontratës sikurse është përcaktuar shprehimisht me DT.
8. Në analizën financiare paga e punonjësve është kalkuluar më pak se 400 euro ndërsa në DT është kërkuar që në analizën financiare të përcaktohet paga bruto 400 euro për një punëtor.
9. Materiali higjienik në paramasë dhe në analizën financiare nuk përputhen mes tyre.
10. Për lot 1 nuk është plotësuar pozicioni në paramasë për materialin higjienik mujore.
11. Për të dy lotet mungojnë faturat për fshesat industriale për larjen e shkallëve (janë kërkuar 5 për lot 1 dhe 3 për lot 2).
12. Për të dy lotet mungojnë faturat për frezat për largimin e borës - pastrues motorik (janë kërkuar 2 për lot 1 dhe 1 për lot 2).
13. Mungojnë faturat për 40 trimera me derivate për lot 2 (janë dëshmuar me faturë 70 për lot 1 aq sa janë kërkuar mirëpo vetëm 30 për lot 2 apo 10 më pak sesa që janë kërkuar për lot 2).
14. Për lot 1 për kranin për pastrimin e xhamave min. 20m lartësi, nuk është dorëzuar asnjë dëshmi se krani i ka 20m lartësi. Në marrëveshjen për marrjen në shfrytëzim të kranit nuk është cekur titulli dhe numri i aktivitetit të prokurimit për të cilin është marrë në shfrytëzim ky kran. Po ashtu për marrëveshja për marrjen në shfrytëzim të këtij krani nuk është e noterizuar (pra nuk është lidhur pranë noterit sikurse është kërkuar me DT) por përmban vetëm një deklaratë të noterit për vërtetim të nënshkrimit ku thuhet shprehimisht se “përmes këtij akti noterial nuk noterizohet përmbajtja e këtij dokumenti por vërtetohet nënshkrimi i palëve dhe rrjedhimisht noteri nuk ka kurrfarë përgjegjësie për përmbajtjen e këtij dokumenti të përpiluar jashtë zyrës noteriale”.

Lidhur me konstatimet e ekspertit shqyrtues duhet theksuar faktin që eksperti shqyrtues nuk ka trajtuar fare pretendimet ankimore. Megjithatë rekomandimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit e ka arsyetuar si vijon “Eksperti shqyrtues gjatë trajtimit të dëshmimeve lidhur me pretendimin për kërkesën sqaron se nuk mund të trajtohet një pretendimin me një kërkesë e cila nuk është në pajtim me rregulloren për prokurim publik nr. 001-2022, neni 18, 18.1 dhe 18.2”. Në këtë rast Paneli Shqyrtues nuk i mbështet përgjigjet e ekspertit shqyrtues për shkak se eksperti shqyrtues sipas vlerësimit të panelit nuk ju është përgjigjur pretendimeve ankimore ashtu sikurse është përcaktuar edhe me nenin 113 dhe 114 të LPP. Duke ju paraqitur palëve dhe

Panelit Shqyrtues, një raport jo profesional, ku tek pjesa e arsytimit/përgjigjeve të tij, shumicën e raportit e plotëson me pjesë të shkëputura nga Dosja e Tenderit, pa argumentim, pa prova dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore, kur mjaftë qartë është e definuar dhe duke ju referuar pjesës VIII dhe IX të LPP sa i përket kompetencave ligjore, dhe funksionimit të OSHP, si dhe duke u bazuar edhe në nenin 116 të LPP, atëherë mund të konstatohet se procedura e vendimarrjes në OSHP bazohet vetëm mbi bazën e provave dhe argumenteve të paraqitura përmes pretendimeve ankimore të palës ankues. Po ashtu, ligjëvënsëi tek neni 108/A të LPP, e ka paraparë se ankesat mund të paraqiten në dy raste ndaj njoftimit për kontratë që do të thotë në fazën para ofertimit dhe pas njoftimit për dhënie të kontratës. Në fazën e para ofertimit çdo palë e interesuar nëse ka interesë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit dhe konsideron se kërkesat e vendosura nuk janë relevante dhe janë diskriminuese si dhe specifikacionet teknike nuk janë konform neni 28 mund të paraqes kërkesë për ri-shqyrtim në AK dhe pastaj ankesë në OSHP, ndërsa, në këtë rast ankesa është paraqitur në fazën e dhënies së kontratës, dhe pretendimet ankimore kanë qenë rreth papërgjegjshmërisë së OE të rekomanduar për kontratë, ndërsa eksperti shqyrtues përgjigjet rreth të metave që posedon Dosja e Tenderit e që në fakt nuk ka qenë detyrë dhe përgjegjësi e tij për shkak se edhe sikur të kishte qenë pretendim i ankuesit në këtë fazë është jo-relevante, ngase secili ofertues ka ofertuar dhe i ka pranuar të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit me rastin e ofertimit të tij në këtë aktivitet të prokurimit.

Përmes nenit 18.1 të RRPP është përcaktuar se “*Autoriteti Kontaktues mund të ndaj aktivitetin e prokurimit në Lote homogjene apo heterogjene. Në të gjitha rastet OE janë të lirë të zgjedhin për sa dhe cilat pjesë do të ofertojnë*”. Ndërsa përmes nenit 18.2 të RRPP është përcaktuar se “*Kurdo që AK ndan aktivitetin në Lote, AK duhet të përcaktoj, në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosje të Tenderit, nëse OE do të shpërblehen për: a) të gjitha Lotet, ose b) një numër të caktuar të Loteve*”.

Në rastin konkret AK ka përcaktuar në dosje të tenderit se OE mund të ofertoj rrjedhimisht edhe të shpërblehet për të gjitha lotet ndërsa paraprakisht ka konfirmuar ndarjen e DT në lote. Kësisoj AK ka vepruar në përputhje të plotë me nenin 18.1 dhe 18.2 të RRPP dhe për këtë arsye Paneli Shqyrtues nuk i ka falur besimin rekomandimeve të ekspertit shqyrtues. Në rastin konkret OE ankues ka aplikuar për të dy lotet mirëpo është eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm për arsyet e elaboruara si më sipër në këtë vendim.

Vlen të shtohet se pretendimet e njëjta ankimore sikurse në ankesë, OE ankues i ka parashtruar edhe përmes kërkesës për rishqyrtim të cilën AK e kishte refuzuar me arsytimin si vijon:

“Sa i përket pikës ankimore nr. 1, në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar është sqaruar në mënyrë të detajuar dhe me argumente arsyet pse parashtruesi nuk ka arritur që të përmbushë kërkesën e DT për vlerën e përgjithshme të kontratave të realizuara në 3 vitet e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë (shih arsyen nr. 1 për eliminim). Në anën tjetër parashtruesi në kërkesën për rishqyrtim nuk paraqet fare kundër-argumente por vetëm thotë se “kemi plotësuar të gjitha sqarimet dhe se vlerën e kërkuar e tejkalojm”. Pra as vet parashtruesi nuk e konteston faktin se “Për kontratën me nr. 9 në listën e kontratave të OE Rio Plus SHPK me blerësin privat Primat ShPK, OE Rio Plus Sh.P.K. nuk e ka dërguar kontratën, kopjet e transaksioneve bankare apo raportet e pranimit të shërbimeve dhe dokumentet tjera të nënshkruara nga blerësit privat sipas kërkesës së AK për sqarime të datës 29.07.2024. Ndërsa kontrata

nr. 11 në listën e kontratave të OE Rio Plus SHPK me blerësin privat Mantro ShPK nuk është marrë parasysh nga AK pasi që kjo kontratë ka përfunduar pas publikimit të njoftimit për kontratë nga AK dhe si e tillë është në kundërshtim me kërkesën përkatëse të DT. Ndërsa për kontratën me nr. 4 në listën e kontratave të OE “Skyferat-Live” Sh.P.K. me AK “Komuna e Gjakovës” me titull “Shërbimet e Pastrimi dhe mirmbajtja hixhenike e objekteve KPSH- Gjakovë”, as pas sqarimeve shtesë që janë kërkuar nga AK me dt. 29.07.2024 nuk është dorëzuar referenca nga AK Komuna e Gjakovës (në vend të saj është lëshuar një referencë nga QKMF Gjakovë në të cilën nuk evidentohet fare titulli i kontratës për të cilën është lëshuar). Ky konstatim është arritur pasi që janë pranuar edhe sqarimet shtesë të parashtruesit. Vlen të shtohet fakti se parashtruesi ka ofertuar për të dy lotet e AP me të njëjtat lista të kontratave. Mirëpo nga cilido këndvështrim i mundshëm, vlera e përgjithshme e të gjitha kontratave tjera të GOE nuk mjaftojnë për të mbuluar vlerën e përcaktuar me DT për lotet që ka ofertuar GOE. Rrjedhimisht pretendimi ankimor është i pabazuar.

Lidhur me pikën ankimore nr. 2, parashtruesi nuk e konteston fare të gjeturën si të tillë. Pra nuk është kontestuese që nuk janë dorëzuar dokumentet përkatëse “Mungojnë MSDS dhe etiket kopje të produktit që është dashur të bashkangjiten me deklaratën e GOE se materialet e përdorura janë ekologjike dhe të atestuara”. Parashtruesi vetëm pretendon që sipas nenit 72 të LPP, është detyrim i AK që “në emër të sqarimeve shtesë” të lejohet parashtruesi që të dorëzojë dokumentet pas hapjes së ofertave. Mbi bazën e mënyrës si është formuluar pretendimi, vlen të citohet nenit 72 i LPP ku thuhet se “Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura”. Pra fillimisht duhet sqaruar se neni 72 nuk e obligon autoritetin kontraktues që detyrimisht të kërkohe sqarime shtesë, por i ofron vetëm mundësinë (pra përdoret termi “mund” dhe jo “duhet” të kërkohe sqarime shtesë). Në rastin konkret AK ka konsideruar që dorëzimi i MSDS dhe etiketave dhe atestet pas hapjes së ofertave do të përbënte ndryshim rrënjësor material të ofertës së parashtruesit. Përmes nenit 32 par. 4 të RRPP është përcaktuar si në vijim “Është përgjegjësi e ofertuesit të ngarkoj të gjitha dokumentet e kërkuara në sistemin e prokurimit elektronik para afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve. Pra është përgjegjësi e vet OE tenderues që të dorëzojë të gjitha dokumentet e kërkuara me DT me rastin e ofertimit. AK nuk ka asnjë përgjegjësi që të përmisoj gabimet eventuale të asnjë tenderuesi gjatë ofertimit. Mirëpo në rastin hipotetik më të favorshëm juridikisht për parashtruesin, edhe po të lejohej ndryshimi i ofertës së parashtruesit përmes sqarimeve shtesë, sërish duhet marrë parasysh që kjo nuk do të ndryshonte aspak epilogun përfundimtar të aktivitetit të prokurimit për faktin se komisioni ka gjetur 14 pika për eliminimin e parashtruesit. Pra 1 arsye eliminuese më pak ose më shumë nuk do të kishte asnjë efekt në epilogun përfundimtar në këtë rast, pa çka se nuk është aspak kontestues fakti që parashtruesi nuk i ka dorëzuar fare dokumentet e kërkuara sipas DT. Prandaj pretendimi ankimor si i tillë është i pabazuar në tërësi.

Sa i përket pikës ankimor nr. 4, vlejnjë përshtatshmërisht sqarimet lidhur me pikën nr. 2. Pra as këtu nuk është kontestues fakti që parashtruesi ka dorëzuar raportin e riskut me afat të skaduar. Prandaj edhe ky pretendim ankimor është i pabazuar.

Sa i përket pikës ankimor nr. 3, kjo pikë i referohet arsyes së tretë eliminuese e cila është formuluar si vijon “Mungon deklaratata se punëtorët do të paguhen jo më vonë se deri me datën 5 të muajit vijues”. Kërkesa e DT ka qenë specifike se duhet të dorëzohet një deklaratë me shkrim e vulosur dhe nënshkruar sipas të cilës punëtorët do të paguhen jo më vonë se deri me datën 5 të muajit vijues. Në anën tjetër parashtruesi pretendon se ka dorëzuar një deklaratë të përgjithshme. Fillimisht duhet cekur se “deklaratata e përgjithshme” siç pretendon parashtruesi nuk është dorëzuar, mirëpo edhe po të ishte dorëzuar ajo nuk është deklaratata që është kërkuar përmes dosjes së tenderit. Kjo sepse përmes DT është kërkuar një

deklaratë e posaçme (jo përgjithshme) e nënshkruar dhe vulosur. Me fjalë të tjera as vet parashtruesi nuk e konteston faktin që mungon një deklaratë e tillë. Prandaj pretendimi ankimor është i pabazuar në tërësi.

Sa i përket pikave ankimor 5, 6, 10, 11, 12 dhe 13, parashtruesi thjesht i kundërshton duke aluduar kinse “janë të pasakta” mirëpo nuk prezanton asnjë argument përse qenkan të pasakta dhe nuk ofron asnjë provë, argument apo dëshmi për të mbështetur pretendimin ankimor. Me fjalë të tjera pretendimet ankimore janë tepër të përgjithësuara sepse vetëm thuhet se “nuk qëndrojnë arsyet eliminuese” por nuk prezantohet asnjë kundër argumet. Prandaj të dy pretendimet ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Sa i përket pikës ankimor nr. 7, parashtruesi i referohet një tjetër kërkesë të DT ndërsa arsyeja eliminuese është krejt tjetër. Kërkesa e DT ka qenë si vijon “OE duhet te kete nje menagjer me pervoj pune se paku 5 vite me page prej 500 euro te perfshihet ne analizen financiare dhe te deshmohet me trust dhe kontrat te punes. Kjo kërkesë vlen per dy lotot (1 dhe 2)”. Mirëpo parashtruesi nuk e ka përfshirë fare menaxherin në analizën financiare në mënyrën sikurse është kërkuar me DT (me pagë 500 euro). Rrjedhimisht arsyeja eliminuese nr. 7 është formuluar si vijon “Në analizën financiare nuk është kalkuluar edhe menaxheri i kontratës sikurse është përcaktuar shprehimisht me DT”. Këtë fakt nuk e konteston as vet parashtruesi pasi që në pretendimin ankimor i referohet krejt një kërkesë tjetër të dosjes së tenderit. Sidoqoftë pretendimi ankimor është i pabazuar në tërësi.

Sa i përket pikës ankimore nr. 8, fillimisht duhet cekur se nuk është kontestues fakti që përmes DT është kërkuar që paga për 1 punonjës të jetë min. 400 euro dhe si e tillë të kalkulohet në analizën financiare dhe paramasë. Pra sipas analizës financiare të parashtruesi, paga për 1 punonjës është 354 euro pavarësisht faktit që në rubrikat 7 të analizave financiare parashtruesi ka kalkuluar pagën së bashku me materialin higjenik. Materiali higjenik është pozicion i ndarë dhe nuk ka asnjë ndërlidhje logjike apo juridike me pagën e punonjësit. Në anën tjetër në rubrikat nr. 1 dhe 4 të analizave financiare vet parashtruesi deklaron se pagat janë nga 354 euro. Duke marrë parasysh faktin që në DT është caktuar shprehimisht se paga duhet të jetë së paku 400 euro, pretendimi ankimor i parashtruesit është i pabazuar në tërësi.

Sa i përket pikës ankimore nr. 9, vlen të shtohet se as vet parashtruesi nuk e konteston faktin që çmimi për materialin higjenik është ndryshe në paramasë dhe ndryshe në analizën financiare. Megjithatë parashtruesi pretendon se dallimi është më pak se 2%. Në rastin konkret duhet cekur se kriteret e dhënies së kësaj kontrate janë tenderuesi i përgjegjshëm me çmimin më të lirë. Sa i përket dallimeve të këtij pozicioni, komisioni ka vlerësuar se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me gabime aritmetike por me çmime të ndryshme të cilat parashtruesi i ka prezantuar në analizë financiare dhe çmime të tjera në paramasë. Pra krejt ndryshe situata do të ishte nëse p.sh parashtruesi në paramasë do të kishte bërë një gabim të paqëllimshëm. në kalkulim (në përlllogaritje). Mirëpo kalkulimi si i tillë në rastin konkret nuk është gabim por i saktë. Problemi qëndron vetëm se për pozicionin e njëjtë të paramasës, tjetër çmim është ofruar në paramasë dhe krejt tjetër çmim është ofruar në analizë financiare. Rrjedhimisht nuk mund të aplikohet fare neni 40.9 i RRPP ku thuhet se “Ne rast se shuma e korrigjuar është me pak se +/- 2%, AK do të përmirësoj gabimet e tilla dhe do të informoj me shkrim OE në fjale duke përdorur formën standarde B49”. Prandaj pretendimi ankimor është i pabazuar në tërësi.

Sa i përket pikës ankimore nr. 14, nga analizimi i ofertës së parashtruesit në kuptim të arsyes 14 të eliminimit është gjetur se për lot 1 për kranin për pastrimin e xhamave min. 20m lartësi, nuk është dorëzuar asnjë dëshmi se kranin i ka 20m lartësi. Në marrëveshjen për marrjen në shfrytëzim të kranit nuk është cekur titulli dhe numri i aktivitetit të prokurimit për të cilin është marrë në shfrytëzim ky kran. Po ashtu për marrëveshja për marrjen në shfrytëzim të këtij kranin nuk është e noterizuar (pra nuk është lidhur pranë noterit sikurse është kërkuar me DT) por përmban vetëm një deklaratë të noterit për vërtetim të nënshkrimit ku thuhet shprehimisht se “përmes këtij akti noterial nuk noterizohet përmbajtja e këtij dokumenti por vërtetohet nënshkrimi i palëve dhe rrjedhimisht noteri nuk ka kurrfarë përgjegjësie për përmbajtjen e këtij dokumenti të përpiluar jashtë zyrës noteriale. Në anën tjetër nuk është kontestues fakti që sipas DT është kërkuar marrëveshja e noterizuar me të dhënat si më sipër të cilat mungojnë. Prandaj pretendimi ankimor është i pabazuar në tërësi. Sa i përket pretendimeve për qasje në dokumente, AK i ka ofruar parashtruesit qasje në të gjitha dokumentet përpos sekreteve afariste në kuptim të nenit 11 të LPP ku përcaktohet se autoriteti kontraktues duhet të respektojë dhe të mbajë si sekret informatat e klasifikuara si informata sekrete afariste në përputhshmëri me këtë nen”.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar me kujdes pretendimet ankimore të OE ankues, elaborimet e ekspertit shqyrtues si dhe konstatimet e autoritetit kontraktues. Me këtë rast Paneli Shqyrtues konsideron se pretendimet ankimore 1, 2, 3, 7, 8, 9 dhe 11 janë të pabazuara në tërësi dhe lidhur me të njëjtat Paneli i ka falur besimin e plotë elaborimeve të autoritetit kontraktues në vendimin e datës 16.08.2024 për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të OE ankues të datës 14.08.2024. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka gjetur se OE ankues nuk ka arritur që të plotësojë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit prandaj vendimi i AK është i bazuar në raport me OE ankues. Në anën tjetër Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet 4, 5, 6, 10, 12, 13 dhe 14 i ka falur vetëm pjesërisht besimin elaborimeve të autoritetit kontraktues në vendimin e datës 16.08.2024 për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të OE ankues të datës 14.08.2024. Megjithatë Paneli Shqyrtues konsideron se nuk ekzistojnë argumente ligjore mbi bazën e të cilave do të duhej që aktiviteti i prokurimit të kthehej në ri-vlerësim sikurse kërkon OE ankues apo të anulohet në tërësi sikurse rekomandon eksperti shqyrtues. Kjo pasi që për anulim nuk janë përmbushur kushtet ligjore sipas nenit 62 të LPP lidhur me nenin 43 të RRPP. Ndërsa në rast të rivlerësimit nuk ekzistojnë argumente sipas të cilave do të mund të ndryshonte epilogu i aktivitetit të prokurimit për shkak të faktit se OE ankues ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme sipas arsyeve të evidentuara më sipër.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkruesat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar ndërsa Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Komuna e Prishtinës i datës 09.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Pastrimin e objekteve edukativo arsimore të Komunës së Prishtinës” me numër të prokurimit 616-24-1099-2-1-1 duhet të mbetet në fuqi, pasi që nuk ekzistojnë argumente të mjaftueshme ligjore për të urdhëruar AK që të kthejë aktivitetin e prokurimit në rivlerësim dhe as për të anuluar aktivitetin e prokurimit, për arsyet e elaboruara si më sipër në këtë vendim.

Paneli Shqyrtues gjatë krahasimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit, ka marrë parasysh edhe nenin 104 par. 4 të LPP ku përcaktohet se *“Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara OSHP duhet të veprojnë në mënyrë proporcionale me shkëlqjen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik”*. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues është nisur nga parimi themelor për mbrojtjen e interesit të publikut në aspektin e parandalimit të vonesave të paarsyeshme në këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veprojnë në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të iniciojë procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimet të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - RIO PLUS SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: